

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22 dhe neni 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10<sup>1</sup> të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), dhe në lidhje me nenin 70, paragrafi (7) dhe paragrafi (8) nga Ligji i njëjtë, nenin 15, paragrafi (1), nënparagrafi 23 dhe nenin 41, paragrafi (1), nënparagrafi 8 të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.ark.01-3632/1 të datës 22.08.2025, duke vepruar sipas Kërkesës me shkrim nr.ark.08-1667/1 të datës 06.04.2026 nga pala e interesuar, personi fizik Biljana Millkova nga Kavadari, në pajtim me Studimin për përcaktimin e arsyeshmërisë për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Kavadarit, nr.ark.08-2679/1 të datës 06.07.2026 dhe Konkluzionin nr.ark.02-2697/3 të datës 09.07.2026, në seancën e 25-të të mbajtur më 09.07.2026, u miratua:

## **VENDIM**

### **për refuzimin e kërkesës për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal në zonën e komunës së Kavadarit**

1. REFUZOHET Kërkesa me shkrim, nr.ark.08-1667/1 e datës 06.04.2026, nga pala e interesuar, personi fizik Biljana Millkova nga Kavadari, për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor radio-folëse muzikore në nivel lokal, në zonën e komunës së Kavadarit, për shkak se me Studimin për përcaktimin e arsyeshmërisë për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Kavadarit nr.ark.08-2679/1 datë 06.07.2026, u konstatua se nuk ekziston arsyeshmëri për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për radio folëse-muzikore në nivel lokal, në zonën e komunës së Kavadarit.

2. Vendimi do të publikohet në faqen e internetit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

3. Ky Vendim është përfundimtar.

## **A r s y e t i m**

Drejtuar Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në adresën zyrtare elektronike ([contact@avmu.mk](mailto:contact@avmu.mk)) me datë 05.02.2026, nga ana e personit fizik Oliver Milkov nga Kavadari, është kërkuar informacion (nr.ark.08-541/1 datë 05.02.2026), nëse për komunën e Kavadarit ka frekuenca të lira për radio muzikore, cilat janë dokumentet e nevojshme për paraqitjen e kërkesës për ndarjen e lejes dhe sa është kompensimi për dhënien e lejes për zonën në fjalë, për të cilën Agjencia me datë 04.03.2026 në mënyrë elektronike i dorëzoi përgjigje.

Në lidhje me kërkesën në fjalë, Agjencia, në pajtim me nenin 70, paragrafi (4) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV-së) më 09.02.2026, drejtuar Agjencisë për Komunikime Elektronike (AKE), dorëzoi Kërkesë për informacion për frekuencë të lirë të mundshme në zonën e qytetit të Kavadarit, si dhe informacion për parametrat teknikë

---

<sup>1</sup> Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 nga Ligji i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.248/18).

bazë mbi bazën e të cilave do të përgatitet zgjidhje teknike për transmetimin e programit në radio në nivel lokal për të njëjtën zonë (nr ynë.ark.08-541/2). AKE, drejtuar Agjencisë, i dorëzoi Njoftimin me nr.ark.0805-452/2 të datës 23.02.2026 (nr ynë.ark.08-541/3 datës 27.02.2026) që bazuar në ndarjet ekzistuese, analizat e shtrirjes radiofonike dhe matjeve në rajonin e qytetit të Kavadarit, parametrat bazë (kryesorë) sipas të cilave duhet të përgatitet zgjidhja teknike për mbulimin e qytetit të Kavadarit janë si më poshtë: „Vendndodhja e transmetuesit: Golem Ljubash, Fuqia efektive e rrezatimit: 300 W dhe Frekuencë: 99.0 MHz.

Me datë 19.03.2026, me kërkesë nga pala e interesuar për dhënien e lejes në selinë e Agjencisë është mbajtur takim për shpjegime shtesë në lidhje me procedurën e përgjithshme për dhënien e lejes për zonën në fjalë në pajtim me LShMAAV-së, gjatë së cilës u theksua se nëse është ende i interesuar për dhënien e lejes për transmetim në radio, në zonën e komunës së Kavadarit, drejtuar Agjencisë duhet të paraqesë kërkesë me arsyetim të detajuar me shkrim.

Me datë 06.04.2026, në adresën zyrtare elektronike ([contact@avmu.mk](mailto:contact@avmu.mk)), Agjencisë iu dorëzua Kërkesë me shkrim, nr.ark.08-1667/1 nga personi fizik Biljana Millkova nga Kavadari, për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimi programor në nivel lokal në zonën e komunës së kavadarit.

Në nenin 70, paragrafi (4) të LShMAAV-së është parashikuar se nëse në pajtim me Planin për ndarjen dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave, përcaktohet se ka radiofrekuenca të lira, Agjencia do të përgatisë studim, me qëllim përcaktimin e arsyeshmërisë për shpalljen e konkursit publik dhe në veçanti nga aspekti i përmbushjes së qëllimit të këtij ligji, si dhe nga aspekti i nevojave të publikut.

Bazuar nga sa më sipër, Agjencia ka përgatitur Studimin, nr.ark.08-2679/1 të datës 06.07.2026, për përcaktimin e arsyeshmërisë për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Kavadarit me qëllim përcaktimin e arsyeshmërisë për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për radio lokale në zonën e komunës së Kavadarit, përkatësisht radio-folëse muzikore, duke pasur parasysh se në Kërkesën e dorëzuar thuhet se bëhet fjalë për radiostacion me koncept muzikor-folës. Studimi bazohet në analizë të ofertës ekzistuese programore, analizë të performancës ekonomike të transmetuesve ekzistues dhe potencialit të tregut. Në pajtim me konkluzionin, gjetjet e Studimi tregojnë se nuk ekziston arsyeshmëri për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për radio-folëse muzikore në nivel lokal në zonën e komunës së Kavadarit. Në këtë zone tashmë dy radiostacione transmetojnë program (ShTR GALAKSI-2002 ShPKNjP Kavadar dhe ShTR RADIO KAVADAR ShPK Kavadar) dhe të dyja janë radio muzikore-folëse me format të përgjithshëm që ofrojnë larmi muzikore dhe janë të orientuara drejtë grupeve të ndryshme të dëgjuesve. Në pajtim me Studimin, të dyja radiostacionet edhe pse kanë të njëjtin format radio folëse – muzikore, kanë koncept programor të ndryshëm dhe publikut i ofrojnë një ofertë të larmishme muzikore, si dhe oferta ekzistuese programore të afuara nga të dy radiostacionet së bashku ku përfshin një larmi përmbajtjesh folëse. Analiza ekonomike tregon se tregu po stonon dhe se ka kapacitet të kufizuar për të siguruar financim të qëndrueshëm. Analiza e treguesve demografikë, ekonomikë dhe financiarë tregon se tregu lokal i radios në zonën e komunës së Kavadarit ka kapacitet real të kufizuar – i cili bazohet në publikun potencial prej 35.773 banorë dhe bazë prej 1.674 subjekte zyrtarë aktivë si reklamues potencial, dhe se të ardhurat që nga reklamimet komerciale i realizojnë radiostacionet ekzistuese nuk shënojnë rritje të vazhdueshme, por përkundrazi në vitin e fundit të analizës kanë rënie dhe dy radiostacionet kanë realizuar fitime maksimale. Kërkesa e paraqitur i referohet radios muzikore-folëse, shërbim programor i cili nuk ndryshon nga konceptet programore të radiove ekzistuese. Dhënia e një leje tjetër për të njëjtin format nuk do të rrisë diversitetin e ofertës programore. Studimi u publikua në faqen e internetit të Agjencisë me datë 06.07.2026<sup>2</sup>

Neni 70, paragrafi (7) i LShMAAV-së, përcakton se nëse me studimin nga paragrafi (4) i nenit 70 nga Ligji i njëjtë përcaktohet se nuk ka arsyeshmëri për shpalljen e konkursit publik, Agjencia në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e publikimit të studimit do të marrë vendim me të cilin refuzon kërkesën nga paragrafi (1) të nenit 70 nga Ligji i njëjtë.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22 dhe nenin 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10 të LShMAAV-së, dhe në lidhje me nenin 70, paragrafi (7) dhe paragrafi (8) nga Ligji i njëjtë, nenin 15, paragrafi (1), nënparagrafi 23 dhe nenin 41, paragrafi (1), nënparagrafi 8 të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike

<sup>2</sup> <https://avmu.mk/wp-content/uploads>

Audio dhe Audiovizuale sipas Kërkesës me shkrim, nr.ark.08-1667/1 datë 06.04.2026 nga pala e interesuar, personi fizik Biljana Millkova nga Kavadarit, në pajtim me Studimin për përcaktimin e arsyeshmërisë për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Kavadarit, nr.ark.08-2679/1 të datës 06.07.2026 dhe Konkluzionin nr.ark.02-2697/3 të datës 09.07.2026, Këshilli i Agjencisë në seancën e 25-të të mbajtur më 09.07.2026, miratoi Vendimin i cili e refuzon lëndën Kërkesë me shkrim nga pala e ineteresuar, për shkak se nga Studimi në fjalë është përcaktuar se nuk ekziston arsyeshmëri për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për radio folëse-muzikore në nivel lokal, në zonën e komunës së Kavadarit.

Bazuar nga sa më sipër, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, miratoi vendimin si në dispozitiv. Vendimi është përfundimtar dhe kundër këtij vendimi, transmetuesi ka të drejtë të ngrejë padi pranë gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit. Vendimi do të publikohet në faqen e internetit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
mr. Sasho Stefanovski d.v.**

**Këshillë juridike:** Ky vendim është përfundimtar, dhe kundër këtij vendimi, transmetuesi ka të drejtë të ngrejë padi pranë gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit.

Përktheu: Antoneta Shabani